



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2022:013482  
Datë: 09.02.2024  
Numri i dokumentit: 05309691

KE.nr. 2115/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike të paditësit Ndërmarrjes Shoqërore nën likuidim KB “Ereniku” – Prodhimtaria Primare në Gjakovë, përfaqësuar nga Autoriteti i Likuidimit Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), me seli në Prishtinë, kundër të paditurës GEO-KAD Sh.P.K., ndërmarrja për punë kadastrale, me seli në Gjakovë, rr. “Tirana”, me objekt kontesti mos përmbushja e kontratës, gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, me datën 09.02.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. Gjykata Komeriale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet JO KOMPETENTE në pikëpamje lëndore, për të gjykuar në çështje kontestimore me numër KE.nr. 2115/22, sipas padisë së datës 24.01.2022, të ushtruar nga paditësi Ndërmarrjes Shoqërore nën likuidim KB “Ereniku” – Prodhimtaria Primare në Gjakovë, përfaqësuar nga Autoriteti i Likuidimit Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), kundër të paditurës GEO-KAD Sh.P.K., ndërmarrja për punë kadastrale, me seli në Gjakovë, me objekt kontesti mos përmbushja e kontratës.
- II. Pas plotfuqishmërisë se këtij Aktvendimi lënda se bashku me shkresat e saj t’i dorëzohet Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

## A r s y e t i m

Paditësi Ndërmarrjes Shoqërore nën likuidim KB “Ereniku” – Prodhimtaria Primare në Gjakovë, përfaqësuar nga Autoriteti i Likuidimit Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), me datë 24.01.2022, ka ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, ndaj të paditurës GEO-KAD Sh.P.K., ndërmarrja për punë kadastrale, me seli në Gjakovë, me objekt kontesti mos përmbushja e kontratës.

Ndërsa, pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda në fjalë është transferuar për shqyrtim në Gjykatën Komerciale të Kosovës dhe ka marrë numrin KE.nr. 2115/22, sipas kompetencës lëndore të kësaj gjykate.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të lëndës në kuptim të nenit 17 dhe 19 të LPK-së, vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës në këtë çështje juridike dhe gjeti se Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje, për arsyet si në vijim:

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditës në këtë çështje kontestimore është Ndërmarrjes Shoqërore nën likuidim KB “Ereniku” – Prodhimtaria Primare në Gjakovë, përfaqësuar nga Autoriteti i Likuidimit Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), ndërsa e paditur GEO-KAD Sh.P.K., ndërmarrja për punë kadastrale, me seli në Gjakovë.

Sipas nenit 5, paragrafi 7 Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës është përcaktuar se: *“Asnjë gjykatë në Kosovë, përveç Dhomës së Posaçme, nuk do të ketë kompetencë apo autoritet mbi asnjë kërkesë, lëndë, procedurë apo rast të përshkruar me paragrafin 1 të këtij neni, përveç atyre që në mënyrë të veçantë përcaktohen në paragrafin 4 të këtij neni...”*. Ndërsa, neni 6 i po të njëjtit ligj përcakton se paditës në procedurën para Dhomës së Posaçme është: *“... 1.3. Agjencia, që pretendon të drejta pronësie apo posedimi apo interesa të tillë mbi apo në: 1.3.1. pasuritë në pronësi apo posedim të një personi fizik apo juridik, apo nën administrimin e autoritetit të saj personal”*. Andaj, meqë palë paditëse në këtë çështje rezulton të jetë ndërmarrja shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, bazuar në dispozitat e cituara si më lartë, kjo gjykatë vlerëson se kompetente për të vendosur është Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Nga sa më sipër, në mbështetje të dispozitave nga neni 17 dhe 19, lidhur me nenin 387.1, pika u) dhe 392, pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 2115/22, datë 09.02.2024

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate